



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 29 mars 2019, në mbledhjen e XVIII (tetëmbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç znj.Fatlume Jaha, e cila mungoi, (Lista e nënshkrimeve)

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të OJQ-ve lokale (Rrjet i OJQ Lokale), përfaqësues të mjeteve të informimit dhe të mediave, dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, thirrja dhe materiali për këtë mbledhje ju është dërguar me kohë, gjithashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa i keni marrë në hyrje të kësaj mbledhje, andaj mund të vazhdojmë me punë, mirëpo para se të fillojmë me mbledhje sigurisht jeni të informuar dhe në dijeni se nga dje më 28 mars 2019 është funksionalizuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ dhe menjëherë ka nxjerrë vendimin për zëvendësimin e një anëtari të Kuvendit të Komunës, fjala është për z.Bunjamin Hoti i cili është emëruar në vend të z.Mirsad Kamerolli, drejtor i tanishëm i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, andaj jemi të obliguar të zbatojmë edhe ne procedurën e dhënies së betimit, prandaj ftoj Komisionin për verifikimin e mandateve të ngritët dhe të bëjë verifikimin e mandatit të këshilltarit të cekur, dhe të paraqes një raport të shkurtër, urdhëroni, z.Avni Fetahu, znj.Doruntina Hasani dhe z.Fatmir Rudari.

z.Avni Fetahu, paraqiti raportin në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit, theksoi, bazuar në Vendimin e KQZ-së me nr. prot.197-2019 të datës 28 mars 2019, z.Bunjamin Hoti emërohet anëtarë i Kuvendit të Komunës së Podujevës nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, duke zëvendësuar ish anëtarin e Kuvendit të Komunës z.Mirsad Kamerolli.

Kryesuesi i Kuvendit, falënderoj Komisionin për verifikimin e mandateve për punën e kryer, theksoi, unë tani ftoj z.Bunjamin Hotin të ngritët në këmbë për dhënien e betimit solemn, unë e lexoj tekstin e betimit Ju i nderuar përsëritni atë me të vetmin ndryshim, përkatësisht e thoni emrin dhe mbiemrin tënd.

Me tekstin së në vijim, anëtari i ri i Kuvendit të Komunës së Podujevës bënë betimin solemn.

Unë, BUNJAMIN HOTI betohem se do t'i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urime i nderuar, tani zyrtarisht jeni këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, ju dëshiroj suksese dhe punë të mbarë.

Prezent janë të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, me përjashtim të znj.Fatlume Jaha e cila mungon, andaj nëse ka ndokush për të marrë fjalën urdhëroni nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së kemi vendos që sot të bojkotojmë këtë seancë të Kuvendit të Komunës me arsyen e vetme që si Grup dhe si këshilltarë të këtij Kuvendi jemi mbledhë dhe kemi bërë një plan të punës së Kuvendit të Komunës në të cilin është paraparë si pikë e rendit të ditës të jetë prezent Kryetari i Komunës dhe të raportoj për projektet të cilat kanë pasë të realizohen në vitin 2018 dhe të tregoj për gjendjen financiare të Komunës së Podujevës. Kryetari i Komunës është duke e injoruar vazhdimisht Kuvendin e Komunës dhe ne nuk do të pranojmë një injorim të tillë, atëherë ne në mënyrë demonstrative do ta bojkotojmë punën e këtij Kuvendi sot.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, paraprakisht shefi i Grupit të këshilltarëve të LVV-së e dha një propozim, është e vërtetë që me planin e punës së Kuvendit nga të gjitha subjektet politike është paraparë dhe miratuar një pikë që në këtë seancë para Kuvendit të Komunës të raportoj Kryetari i Komunës për gjendjen financiare, punët e kryera, dhe premtimet e mos kryera në Komunën e Podujevës të cilën e drejton ai. Andaj që nga konsolidimi i organeve të Komunës, vetëm në ditën e betimit ka qenë këtu në sallë, por në bazë të betimit që e ka bërë Kryetari i Komunës nuk e mbajti premtimin dhe betimin e dhënë para Kuvendit, që të raportoj për gjendjen ashtu siç parashihet me ligj së paku dy herë në vit, si dhe të përgjigjet në pyetjet e drejtpërdrejta të këshilltarëve. Sjellja e tillë e Kryetarit të Komunës na obligon që të marrim një veprim të tillë. Në parim besoj se është obligim moral, juridik dhe njerëzor i çdo asamblisti të Kuvendit të Komunës së Podujevës, pa dallime politike për arsye se të gjithë ne përfaqësojmë partitë politike, por premtimet që janë dhënë para qytetarëve të Komunës së Podujevës që në Kuvendin e Komunës do t'i mbrojmë interesat e qytetarëve pa barrikadim politikë, që të marrim një veprim të tillë, përderisa Kryetari i Komunës dhe organet e zgjedhura prej tij, si dhe Drejtorët politik, asnjëherë që nga konsolidimi i organeve të Komunës nuk kanë mund të na japin përgjigje direkte për pyetjet tona që i kemi bërë dhe të ndërlidhura direkt me punën e tij. Andaj materialet e sjella për shqyrtim dhe miratim në këtë seancë, janë të sjella sikurse që sjellën me postë, kështu që Grupi i këshilltarëve të PDK-së është konsultuar edhe me akterët tjerë politik opozitar dhe ka marrë qëndrim që seancën ta bojkotoj deri sa Kryetari i Komunës të jetë prezent në sallë dhe derisa të respektohet plani i punës së Kuvendit i miratuar edhe nga Kryesuesi i Kuvendit edhe nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së i cili është subjekt në pushtet. Për mungesën e Kryetarit të Komunës në këtë mbledhje të paktën nuk kemi pas edhe ndonjë njoftim paraprak, qoftë zyrtar apo privat se do të mungoj në këtë mbledhje, dhe që raporti do të bëhej në seancën tjetër të radhës.

Sipas deklarimeve paraprake të dy parafolësve, lëshohet salla në shenjë bojkotimi të mbledhjes nga këshilltarët e LVV-së, PDK-së, AAK-së dhe një anëtar i PSD-së

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pas lëshimit të sallës, përkatësisht deklarimit për bojkotim të kësaj mbledhje nga këshilltarët e PDK-së dhe të LVV-së, mbështetur edhe këshilltarët e subjekteve tjera opozitare, pas konstatimit të kuorumi, në pajtim me nenin 32.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, jep pauzë 30 minuta, dhe fton këshilltarët e Kuvendit që të marrin pjesë në këtë mbledhje e cila do të filloj në ora 11:00.

Pauza nga ora 10:30

Mbledhja rifillon në ora 11:30

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përshëndeti pranishmit, theksoi, konsideroj se rrethanat dhe kushtet ligjore ekzistojnë për këtë mbledhje, për hir të transparencës dhe konstatimit të kuorumi, ftoj zyrtarin për punë të Kuvendit të thërras emër për emër këshilltarët e Kuvendit të nënshkruar pas pauzës në listën e nënshkrimeve, kjo për shkak se para rreth një ore kur filluam me këtë mbledhje ende pa u miratuar rendi i propozuar i ditës, nga disa Grupe të këshilltarëve të Kuvendit u deklarua se këtë mbledhje do ta bojkotojnë dhe të njëjtit lëshuan sallën.

Konstatohet se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje, ngase nga 35 këshilltarë të Kuvendit, prezent në sallë janë 18 këshilltarë/e, si në vijim:

1. *Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit*
2. *Avni Fetahu*
3. *Bunjamin Hoti*
4. *Agron Hyseni*
5. *Afrim Shabani*
6. *Agim Behluli*
7. *Liridona Shabani*
8. *Hasan Ajeti*
9. *Adnan Zymeri*
10. *Mehmet Gashi*
11. *Qëndrim Softolli*
12. *Arlinda Kadriu*
13. *Valbone Kadriu – Podvorica*
14. *Donjeta Jakupi*
15. *Mrika Thaqi*
16. *Tringa Sfishta*
17. *Avni Islami, dhe*
18. *Benjamin Ejupi*

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë kuorumi u konstatua se ekziston, vazhdojmë me punë. Nëse ndokush ka diçka rreth rendit të propozuar të ditës, urdhëroni, nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 18 këshilltarë sa ishin prezent në sallë, njëzëri me 18 vota për u miratua rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

1. Nisma e Kryetarit të Komunës për themelimin e bashkëpunimit ndër – komunal

- *Propozim vendimi për miratimin e Kërkesës – Nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal*
- *Propozim vendimi për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër – komunal*

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, rreth kësaj pike kemi të bëjmë me kërkesën – nismën e Kryetarit të Komunës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal duke përfshirë edhe dy propozim vendimet përkatëse sipas materialit. Nismë e cila siç edhe keni vërejtur në materialin e dërguar ka të bëjë me bashkëpunim mes 4 Komunave, përkatësisht nga Kryetarët e tyre të cilët kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për këtë çështje, fjala është për aplikim në donacionet e USAID përmes MAPL-së ku të drejt aplikimi kanë të gjitha Komuna me kusht që projektet të jenë në interes të përgjithshëm të komuniteteve të tyre. Afati për aplikim është deri më 10 prill 2019, kështu që pasi është interes i Komunës së Podujevës dhe Komunave tjera përkatëse, është mirë që të kryejmë punën tonë si Kuvend i Komunës në mënyrë që t'i mundësohet aplikimi në donacionin e cekur brenda afateve të përcaktuara. Projekti në fjalë përfshinë rrugën nga fshati Lupç tek ish kazerma e ushtrisë në magjistralen Podujevë – Prishtinë deri në fshatin Kozaricë, dhe përfshihen 4 Komuna, Podujevë, Prishtinë, Vushtrri dhe Obiliq. Andaj urdhëroni fjala për ju, nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim Nismën e Kryetarit të Komunës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal në pako duke përfshirë edhe dy (2) propozim vendimet përkatëse të bashkëngjitura me material.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 18 këshilltarë sa ishin prezent në sallë, njëzëri me 18 vota për, u miratua Nisma e Kryetarit të Komunës për themelimin e bashkëpunimit ndër – komunal, përkatësisht:

- *Propozim vendimin për miratimin e Kërkesës – Nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal.*
- *Propozim vendimin për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër – komunal*

2. Informatë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për punët dhe aktivitetet gjatë vitit 2018

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, në cilësinë e koordinatorit të KKSB-së, e paraqiti informatën, ndër të tjera theksoi, kjo informatë është paraqitur në bazë të planit të punës së Kuvendit me të cilin është paraparë një e tillë në të cilën është paraqitur e gjithë puna dhe aktivitete e KKSB-së gjatë vitit 2018. Është një dokument paksa voluminoz por qëllim ka qenë që të gjithë të njoftohen sa më detaje për punën e Këshillit në vitin 2018, dhe unë nuk do të zgjasë shumë ngase materiali ju është dërguar me kohë dhe të gjithë keni pas rastin ta lexoni dhe analizoni, por jam i hapur që të jap sqarime dhe përgjigje në rast se paraqiten kërkesa të tilla, edhe pse janë të gjitha temat e trajtuara, rekomandimet, statistika të ndryshe të organeve dhe institucioneve të ndryshme etj, të cilat janë shumë të rëndësishme për Kuvendin dhe qytetarët sa i përket rrjedhës së sigurisë në Komunën e Podujevës gjatë vitit 2018.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj Drejtorin parafolës i cili në cilësinë e koordinatorit të KKSB-së ka sjellë këtë informatë dhe i cili po ashtu paraqiti edhe sqarime shtesë në fjalën hyrëse, andaj kalojmë me diskutime.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së, informatën për punët dhe aktivitetet e KKSB-së për vitin 2018 e vlerëson shumë të rëndësishme për tu njoftuar në mënyrë kronologjike për aktivitetet e Këshillit në fjalë. Shihet qartë se KKSB ka pasqyruar një varg aktivitetesh lidhur me sigurinë në bashkësi, aktivitete të cilat kanë aktivizuar Ekzekutivin e Komunës, shoqërinë civile, komunitetin fetar dhe të tjerët, me qëllim të arritjes së objektivave të synuara. Përveç aktiviteteve të pasqyruara në informatë, KKSB ka përgatitur edhe planin e punës për vitin 2019 i cili është prezantuar edhe në seancën e kaluar ku edhe është miratuar. Neve na gëzon fakti që një nga pikat e sugjeruara nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së është përcjellë më tutje edhe në instanca tjera, fjala është për shkollat, këshillat e prindërve dhe këshillat e nxënësve, për çka e falënderojmë Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili e ka marrë me shumë seriozitet këtë çështje. Gjithashtu ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së kemi diskutuar edhe një çështje të cilën edhe sugjerojmë të ndodh edhe tek ne, fjala është për një praktikë të Shqipërisë, ku mbledhjet e Këshillave të tillë për Siguri në Bashkësi ka raste kur mbahet në natyrë sidomos kur ka pas për trajtim tema rreth ambientit, pra do të ishte mirë të merrnim një praktikë të tillë edhe ne dhe të mundohemi të sensibilizojmë edhe masën në këtë formë që një nga aktivitetet pse të mos mbahet edhe në natyrë e që mendoj se do të përcillej edhe nga mediat dhe do t'i jepte pamje më të mirë edhe vetë KKSB-së.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, konsideroj se të gjithë e keni analizuar informatën në fjalë e cila vërtetë paraqet gjitha punët dhe aktivitetet e Këshillit gjatë vitit 2018, andaj e konsideroj të mbyllura diskutimin rreth kësaj informate dhe vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës.

3. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019 dhe destinim në kategori të caktuara buxhetore

z.Isuf latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, pasi që në mbledhjen paraprake ne kemi dhënë të gjitha sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme sa i përket bartjes së të hyrave vetanake sipas propozim vendimit përkatës, andaj tani do të jem shumë i shkurtër në këtë aspekt. Ashtu siç është cekur edhe në mbledhjen e kaluar, të hyrat vetanake të inkasuara dhe të pashpenzuara në vitin 2018 sipas ligjeve në fuqi barten në vitin 2019 gjegjësisht në projektet sipas specifikacionit të bashkëngjitur në propozim vendim. Meqë e shohë të panevojshme të jap edhe njëherë sqarimet dhe arsyet e njëjta sikurse në mbledhjen paraprake të Kuvendit, dëshiroj t'ju njoftoj vetëm me një ndryshim i cili është për dallim nga propozim vendimi i mbledhjes së kaluar, fjala është për një shumë të mjeteve buxhetore prej 3,874.80 € e cila është shtuar në këtë propozim vendim si pasoj e gjobave të Gjykatave që janë sjellë me raport pas mbledhjes së kaluar, kështu që këto mjete janë propozuar të destinohen në projektin “zgjërimi i hapësirave publike” sipas specifikacionit të bashkëngjitur propozimit në fjalë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ka ndokush për të marrë fjalën rreth këtij propozim vendimi, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 18 këshilltarë sa ishin prezent në sallë, njëzëri me 18 vota për, u miratua propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019 dhe destinim në kategori të caktuara buxhetore.

4. Raporti financiar për vitin 2018

z.Isuf latifi, Drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, ne si Drejtori e Buxhetit dhe Financave jemi të obliguar të prezantojmë në Kuvendin e Komunës raportin vjetor financiar pas përfundimit të çdo viti fiskal, raport i cili ka për qëllim që në veçanti Kuvendi i Komunës në mënyrë të detajuar të jetë në dijeni për buxhetin e miratuar, mjetet buxhetore të alokuara, ato të shpenzuara, për bilancin e pashpenzuar, për të hyrat vetanake të mbledhura dhe të shpenzuara, si dhe me treguesit tjerë ekonomik. Lidhur me këtë raport, edhe pse ju është dërguar të gjithëve me kohë dhe besoj se e keni analizuar, do të paraqesë një informatë të shkurtër lidhur me shpenzimet totale në nivel komunal, me shpenzimet të cilat kanë ndodhur të ndara sipas kategorive ekonomike dhe sipas burimit prej nga ato shpenzime janë financuar, pa dashur t'i përsërisë shifrat ngase janë të përkrahura në raport, mirëpo vetëm vlen të ceket se buxheti i alokuar për vitin 2018 është 21,058,978.00 €, përfshirë edhe donacionet. Nga kjo shumë janë shpenzuar 18,791,169.00 €, apo 89.24.%, e që nëse e krahasojmë me vitin paraprak është përafërsisht i njëjtë me një ngritje të vogël. Në vazhdim paraqes shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe atë: -paga dhe mëditje 11,763,934.00 €, -mallra dhe shërbime 1,471,236.00 €, -komunali 321,171.00 €, -subvencione 506,581.00 €, dhe -investime kapitale 4,728,240.00 €. Nga kjo mund të konstatojmë se pjesa më e madhe e buxhetit shkon për paga e pastaj për investime kapitale.

Gjithashtu në raport janë paraqitur në mënyrë tabelore shpenzimet sipas Drejtorive, sipas kategorive ekonomike, sipas fondeve duke paraqitur buxhetin e aprovuar, buxhetin e lejuar, buxhetin e shpenzuar, realizimin e buxhetit të shpenzuar në përqindje, janë paraqitur pagesat sipas programeve dhe sipas kategorive ekonomike për secilin veç e veç, si dhe shpenzimet sipas kodeve ekonomike, sipas burimit të mjeteve duke bërë krahasim edhe me vitin 2017.

Në vazhdim e shohë të arsyeshme të përmendi disa aktivitete kryesore të cilat janë të përkrahura edhe ne raport për periudhën raportuese, si vijon; gjatë vitit fiskal 2018 janë ndërtuar rrugë të shumta lokale me një vlerë mbi 2,300,000.00 €, janë ndërtuar dhe riparuar objekte arsimore në vlerë mbi 340,000.00 €, objekte kulturore dhe sportive në vlerë 120,000.00 €, ndërtim të trotuareve me një vlerë mbi 300,000.00 €, kanalizime dhe kolektor afër 740,000.00 €, ndriçim publik 170,000.00 €, objekte shëndetësore 50,000.00 €, rregullim të lumenjve mbi 300,000.00 €, rregullim të parqeve dhe hapësirave publike afër 300,000.00 €, etj, pra këto janë disa nga shpenzimet për investime kapitale, mirëpo Komuna e Podujevës gjatë vitit 2018 ka shpenzuar edhe për punë dhe aktivitete tjera të cilat po i klasifikojmë si shpenzime rrjedhës nga te cilat vlen të ceket se janë mbështet me subvencione 430 fermer në projekte të ndryshme si; serra, shoqëri bletësh, pajisje për bletari, makina mjelëse, sistem për ujitje, e që marrë në total të gjitha këto kanë një vlerë mbi 265,000.00 €, pastaj janë përkrahur 305 qytetarë/e me gjendje të rend sociale dhe shëndetësore me një vlerë totale mbi 32,000.00 €, mandej janë mbështetur 553 familje me rastin e vdekjes së ndonjë anëtarit të familjes së tyre ku shuma e kësaj mbështetje-subvencionimi arrin 107,900.00 €.

Po ashtu, në kuadër të këtyre shpenzimeve, janë mbështetur rreth 170 student dhe nxënës të shkollave të mesme me një vlerë prej 39,900.00 €, është mbështetur Organizata "Hendikos" me një shumë mbi 14,000.00 €, për aktivitete e saja me njerëzit me nevojë të veçanta, gjithashtu mbështetje kanë përfutur edhe OJQ të ndryshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit me një vlerë mbi 40,000.00 €. Vlen të theksohet se në mënyrë të përhershme mbështeten me transport Podujevë – Prishtinë dhe anasjelltas, 2 deri 3 herë në javë 35 pacient me Hemodializë nga lokalitete të ndryshme të Komunës së Podujevës.

Janë ofruar shërbime emergjente shëndetësore për qytetarët e Komunës së Podujevës të cilët sipas nevojës orientohen në QKUK – Prishtinë, me një mesatare 79 raste në muaj, apo mesatarisht 2.6

shkuarje-ardhje në ditë, si dhe shumë shërbime tjera të zakonshme të cilat natyrisht se kanë një kosto. Mandej, Shërbimi i zjarrfikëseve ka qenë në shërbim të qytetarëve të Komunës së Podujevës duke pas 708 intervenime të ndryshme gjatë gjithë vitit 2018.

Për fund, kemi raportin e të hyrave të parashikuara, të hyrave të realizuara të përshkruara sipas kodeve ekonomike, si dhe të hyrat nga dënimet e Policisë së Kosovës, dënimet nga Gjykatat si dhe të hyrat nga Agjensioni i pyjeve, dhe kur diskutojmë për të hyrat vetanake duhet të cekim se jemi të brengosur me përqindjen jo të kënaqshme të inkasimit, e që është 81%, por është e nevojshme të ceket se ndikim negativ i rënies së të hyrave është edhe Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjopa komunale e cila ka hyrë në fuqi nga muaji prilli 2018 e që është heq taksa mbi transaksionet e pronës dhe që ka pasë impakt negativ në realizimin e të hyrave, mirëpo na gëzon fakti që realizimi i tatimit në pronë është arrit 107%, si e hyrë kryesore e për Komunën, por pavarësisht kësaj kur jemi te tatimin në pronë, dëshiroj të bëjë apel të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës që të kryejnë obligimin e tyre qytetarë ndaj Komunës, ngase ju kthehen direkt atyre përmes projekteve kapitale, andaj të nderuar këshilltar të Kuvendit kërkoj që edhe ju të kontribuoni në këtë drejtim sepse çdo vonesë e mos pagesës së tatimit në pronë pason me ndëshkim si pas ligjit, kurse ne nuk jemi që qytetarët ndëshkohen, përkundrazi jemi që ata ndihmohen.

Krejt në fund, vlen të ceket se këtë raport financiar e karakterizon një ekzekutim i buxhetit prej 91.40%, kurse totali i realizimit të buxhetit duke përfshirë të hyrat dhe donacionet, është 89.24%, dhe është një inkasim i të hyrave prej 81%.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj Drejtorin e DBF për këto sqarime të detajuara rreth raportit financiar për vitin 2018.

z.Adnan Zymeri, theksoi, më lejoni fillimisht që në emrin tim personal ti uroj mirëseardhje dhe mbarësi në punë mikut tim të mirë Bunjamin Hotit, i cili nga sot do të ketë mundësi të ushtroj të drejtën e tij për ti kontribuar mirëqenies dhe interesit të qytetarëve.

Sa i përket vlerësimit për raportin financiar të vitit 2018, duhet ditur që esenca e paraqitjes së këtij raporti është të njihemi me nivelin e përmbushjes së pikësnyimeve të parapara nga Komuna gjatë vitit fiskal. Nga shuma e përgjithshme e buxhetit të alokuar, përqindja e realizimit të këtij buxheti është gjeneralisht e kënaqshme, kuptohet me disa elemente të nevojshme për tu përmirësuar, mirëpo që janë të natyrshme marrë parasysh që ajo çka planifikohet dhe çka realizohet nuk del të jenë gjithëherë të njëjta dhe nuk varen vetëm nga faktori njeri. Në kuadër të shpenzimeve për kategoritë buxhetore me impakt direkt për qytetarët, janë realizuar projekte dhe investime kapitale të cilat lehtësojnë jetën e tyre, duke filluar nga rrugët, parqet, trotualet etj. Natyrisht që përkundër kompleksitetit të projekteve të kësaj fushe ka qenë intensë e vazhdueshme përmbyllja e tyre para dinamikes së përcaktuar me qëllim që të shfrytëzohen sa më parë nga qytetarët e Podujevës me përkatësi të çfarëdoshme politike sikur ndodh çdo ditë. Subvencionet janë realizuar në masën e 96.41% që nënkupton efikasitet të lartë i cili është kthyer në mbështetje konkrete për qytetarët e Komunës së Podujevës. Vlen të theksohet mbështetja në fushën e bujqësisë, ku kanë përfituar bletarë e blegtorë, fermer të vyer që më bashkëpunimin e mirë me Komunën e Podujevës kanë bërë që Podujeva të vendoset në hartën e qyteteve të Kosovës me dy brende të saj bujqësore. Kështu që marrë parasysh atë çfarë u tha më lartë, Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështet këtë raport, normalisht duke qenë i hapur edhe ndaj kontributeve individuale të secilit nga ju.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë raport financiar.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 18 këshilltarë sa ishin prezent në sallë, njëzëri me 18 vota për, u mbështet raporti financiar i Komunës së Podujevës për vitin 2018

5. Propozim Plani i veprimit për transparencë për periudhën 2019 – 2023

z.Mehmet Gashi, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e kemi shqyrtuar propozim Planin e veprimit për transparencë në Komunën e Podujevës për periudhën 2019-2023, dhe e përkrahim këtë propozim Plan dhe konsiderojmë se është në përputhje të plotë me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së për transparencë në Komuna, Statutin e Komunës dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Në shoqëritë demokratike vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e vetëqeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies, pjesëmarrjes publike, ofrimit të shërbimeve publike në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në procese të tilla, andaj me këtë propozim Plan për transparencë janë përfshirë objektivat e veprimit për transparencë, prandaj ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim dhe propozojmë që si i tillë të miratohet.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe unë desha të jap një informatë shtesë rreth këtij propozim plani për transparencë, deri më tani sipas Udhëzimeve Administrative për Transparencë, ka qenë e rregulluar që për çdo vit të miratohet plani i veprimit për transparencë në komuna, ndërsa tani e tutje me Udhëzimin e ri Administrativ një plan i tillë miratohet për periudhë 4 vjeçare. Urdhëroni nëse dëshiron ndokush të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse nuk ka e hedh në votim.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 18 këshilltarë sa ishin prezent në sallë, njëzëri me 18 vota për, u miratua propozim plani i veprimit për transparencë për periudhën 2019 – 2023 sipas materialit përkatës.

6. Raporti i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për punët dhe aktivitetet e kryera gjatë vitit 2018

z.Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, në fjalën hyrëse paraqiti këtë raport, ndër të tjera theksoi, në fakt këshilltarëve të Kuvendit ju është dërguar raporti i DSHMS-së për punët dhe aktivitetet e Drejtorisë gjatë vitit 2018, raport i cili përfshinë edhe dy sektorët tjerë që janë Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – QKMF dhe Qendra për Punës Sociale – QPS. Konsideroj se në dokumentin e raportit janë të përshkruara në detaje të gjitha aktivitetet duke mos përfshirë ndonjë lëshim eventual qoftë teknik qoftë të ndonjë natyre tjetër, mirëpo jemi të gatshëm që për çdo paqartësi apo sugjerim tuajin të marrim me seriozitet në kuptimin e përmirësimit edhe pse ky është një raport pune për vitin 2018, ne do t'i marrim me pozitivitet të gjitha sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet e juaja me qëllim të përmirësimit të shërbimeve në mënyrë që qytetarët tanë të mund të marrin shërbime shëndetësore dhe shërbime sociale më efikase. Duke marrë për bazë që të gjithë ju e keni marrë me kohë këtë raport dhe e keni lexuar dhe analizuar, nuk do t'ju marrë shumë kohë por mbetem i gatshëm të japë përgjigje dhe sqarime aq sa kemi mundësi me qëllim që të përmirësojmë diçka rreth aktiviteteve tona.

z.Hasan Ajeti, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së mbështet raportin e DSHMS-së për vitin 2018. Ne të gjithë jemi dëshmitarë se një ndër dikasteret kryesore që ende mbetet problem jo vetëm për Komunën tonë, është sektori i shëndetësisë, i cili në Komunën e Podujevës gjatë vitit 2018 ka ofruar shërbime shëndetësore në QKMF, në QMF dhe në AMF-të që gjenden në vende të ndryshme të Komunës së Podujevës, natyrisht duke u kryer edhe vizita të ndryshme.

DSHMS brenda mundësive buxhetore ka arritur që vitin 2018 ta përmbyllë në mënyrë të kënaqshme duke marrë gjithmonë kompleksitetin e natyrës që përballën për çdo ditë profesionistët shëndetësor. Po ashtu DSHMS për vitin 2018 ka arritur që përmes investimeve kapitale të realizoj ndërtimin e objektit të ri të ambulantes në fshatin Majac, ndërtimin dhe montimin e kaldajës në QKMF si dhe blerjen e pajisjeve të reja mjekësore. Sa i përket sektorit për mirëqenie sociale, është një ndër sektorët më të ndjeshëm në shoqërinë tonë pasi që lidhet drejtpërdrejt me nevojën dhe kërkesën urgjente për asistencë sociale që kanë një pjesë e qytetarëve tanë, dhe përkundër vullnetit dhe dëshirës që kanë organet respektive të Komunës së Podujevës në ofrimin e ndihmës për kategoritë në fjalë, përcaktues absolut është mundësia buxhetore e Drejtorisë, andaj edhe përkundër vështirësive DSHMS ka arritur që brenda vitit 2018 të ndërtoj dhe të ndaj 20 shtëpi për banim social në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, gjithashtu ky sektor në bashkëpunim me donatorë ka arritur që 14 familjeve t’iu ndërtohen shtëpi ku 2 prej tyre kanë qenë të propozuara nga ky sektor. Gjithashtu me mjete vetanake financiare të DSHMS-së janë ndihmuar edhe familje të ndryshme si dhe është ndihmuar Shoqata “Handikos” – Podujevë. Po ashtu në bashkëpunim me donator, sektori në fjalë ka arritur të realizoj 17 projekte për kategoritë sociale, andaj për këto dhe arsye tjera Grupi i këshilltarëve të LDK-së mbështetë këtë raport pune të DSHMS-së për vitin 2018.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, e konsideroj të mbyllur debatin përkatësisht këtë pikë të rendit të ditës.

7. Informatë për aktivitetet dhe gjendjen në Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, e paraqiti informatën, ndër të tjera shtoi, kjo informatë është përgatitur dhe sjellë në Kuvend me kërkesë këshilltarëve të Kuvendit. Njësia e zjarrfikjes, sipas ligjit përkatës të vitit 2011 është përgjegjëse për pjesëmarrje dhe intervenime për zjarrfikje, shpëtimin e njerëzve dhe pasurive në të gjitha situata emergjente. Njësia në fjalë në Komunën e Podujevës ka një staf prej 18 zyrtarëve, staf profesional dhe i trajnuar në vazhdimësi për raste emergjente dhe e cila punon pandërprerë 24 orë duke organizuar punën në 4 ndërrime, gjithashtu kjo Njësi është mirë e pajisur me automjetet edhe pse për një kohë të gjatë automjetet kanë qenë kryesisht nga donacionet e jashtme dhe të vjetërsuara por kohëve të fundit Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Menaxhimit Emergjent – AME, kanë pajisur me dy automjetet të reja dhe ka ndikuar dukshëm efikasitetin e kësaj njësie. Po ashtu nga viti i kalua Njësia e zjarrfikjes është vendosur në objektin e ri dhe ka hapësirë të mjaftueshme qoftë për stafin qoftë për automjete etj. Megjithatë duke krahasuar hapësirën territoriale të Komunës së Podujevës si më e madhja me territor në Republikën e Kosovës, si dhe me një numër bukur të madh të banorëve. Njësia në fjalë ka një numër të vogël të stafit dhe nuk mbush nevojat e tyre sidomos gjatë sezonit verorë, prandaj shumë herë jemi detyruar të kemi edhe staf mbështetës me kontrata për shërbime të veçanta. Në 5 vitet e fundit Njësia e zjarrfikjes për çdo vit ka nga 700 deri në 1000 intervenime të ndryshme zjarrfikje, vërshime etj.

Sa kujtoj në fillim të muajit shtator të vitit 2012 kanë filluar procedurat e transferimit të Njesisë së zjarrfikjes në kuadër të AME dhe më 19 shtator 2012 ky proces ka kaluar në këtë Agjenci, mirëpo edhe pavarësisht këtij transferi AME kryesisht punën e ka lënë sërish në Komuna sepse nuk i ka bartur të gjitha kompetencat në kuadër të zhvillimit të saj.

Lidhur me rastin për të cilin është kërkuar kjo informatë, keni në dokumentacion që fillimisht punëtori Baki Tahiri ka kërkuar pushim pa pagesë për shkaqe dhe probleme të theksuar shëndetësore

për shërim jashtë vendit dhe duke u bazuar në diagnozën e sëmundjes dy herë i është lejuar pushim pa pagesë nga Zyra e personalit sipas aktvendimeve të cekura në informatë, njëri 6 muaj, njëri dy muaj. Edhe pse pushimi pa pagesë nuk ka qenë i mjaftueshëm është kërkuar edhe lejimi i pushimit vjetor si dhe shfrytëzimi i orëve të lira, për shërim jashtë vendit, e që është liruuar sepse në raste të tilla edhe kur ka pushim, në raste emergjente detyrohen të kthehen në vendin e punës. Pavarësisht këtyre punëtorit në fjalë në një periudhë disa vjeçare, në periudha të caktuara ka munguar dhe është zëvendësuar nga punëtorët e ndërrimit. Më datë 10.09.2018, nga komisioni disiplinor i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe punëtori në fjalë nuk ka paraqitur ankesë. Gjithashtu komisioni disiplinor në muajin janar të vitit 2019 ka marrë vendim me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore për zëvendësim të punëtorit pa respektuar procedurat ligjore edhe ndaj shefit të Njesisë së zjarrfikjes, përkatësisht pezullim nga detyra me 50% të pagës për dy muaj, pavarësisht mënyrës së zëvendësimit dhe arsyeshmërisë, konstatimit nga komisioni disiplinor, shkeljeve të proceduarve të zëvendësimit dhe mungesës në punë, nuk kemi dëmtim të buxhetit publik sepse nuk kemi pagesë për mungesë të shërbimit dhe nuk kemi pagesë të dyfishtë për shërbimin. Vlerësojmë se masat e ndërmarra dhe masat tjera ende rreth rastit, për raste të tilla do të jenë në funksion të plotë të respektimit të ligjshmërisë. Shërbimi i zjerrfikjes gjatë gjithë periudhave, në përpikëri i kryen obligimet zyrtare dhe shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë që gjatë kësaj periudhe kanë qenë në nivelin më të lartë të shërbimit. Unë kam takuar të gjithë punëtorët e Shërbimit të zjarrfikjes me të cilët kemi biseduar hapur për të gjitha shqetësimet, problemet dhe angazhimeve të tyre me qëllim të tejkalimit të pakënaqësive të tyre që kanë dhe për respektimin e ligjeve që iu referohen zjarrfikësve. Në veçanti vlen të falënderohet Shërbimi i zjarrfikjes që në këto ditë gjatë ushtrimit fushor ‘‘Skifteri 03’’ së bashku me FSK-së dhe ekipet tjera emergjente si, Policinë, AME-në, Kryqin e kuq, etj, kanë qenë në nivelin më të lartë profesional të kryerjes së detyrave, dhe këto jo vetëm që janë vlerësime tonat, por janë vlerësime edhe të AME-së dhe FSK-së sepse vërtetë të gjithë punëtorët kanë kryer trajnime të shumta për çdo vit dhe të gjithë janë efikas në punët e tyre. Më vie keq që shumë herë raportet e tyre nuk kemi mund t’i tejkalojmë që janë raporte të menaxhimit dhe të tjera por që shpresojmë që shumë shpejt që këto raporte të punëtorëve në fjalë sa i përket menaxhimit më të saktë do të tejkalohen.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe pse informata ka qenë e shpërndarë te këshilltarët e Kuvendit, falënderoj Drejtorin e DSHPMSh që edhe njëherë këtu në Kuvend e paraqiti dhe konstatoj gjendjen rreth Njesisë së zjarrfikjes, nëse ka të interesuar të merr fjalën, urdhëroni, nëse jo e konsideroj të mbyllur edhe këtë pikë të rendit të ditës.

8. Të ndryshme

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marr fjalën, Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar të pranishmit, me theks përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e OSBE-së dhe Radio Llapin për përcjelljen e vazhdueshme të mbledhjeve, e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:20

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/04-00227745/19
Podujevë,
29 mars 2019

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi